

17.03.25

Pyetjeve ketu + kopje
Hajzi Terbuq + kopje
per neputur
te mtejshme

H. Terbuq
72/4
17.03.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



Shkodër, më 13.03.2025

Nr. 185 /1prot.

Lënda: Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Pukë Nr.06, datë 25.02.2025.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, Aneksi I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.2, germa a dhe c, neni 27 pika 5, neni 54/n, neni 55/3, neni 64 germa c, neni 11, pika 2/b të Ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet”, VKM Nr.433 date.8.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave dhe bashkive” të ndryshuar, shtojca 48, ligjit Nr.111/2024 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9693/2007 “Për fondin kullosor” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit Nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkitimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, dokumentacionit të depozituar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Pukë Nr.374/5 prot datë 03.03.2025, analizoi Vendimin e Këshillit Bashkiak Pukë Nr.06, datë 25.02.2025, rishqyrtim i VKB Nr.55 datë 3.12.2024 “Mbi miratimin e planit të mbarëshimit të ekonomisë pyjore “Gomsiqe”, në Njësinë Administrative Qerret të Bashkisë Pukë”.
Pas plotësimit të dokumentacionit sipas kërkesës së Prefektit me shkresën nr.826/1 prot, datë 19.12.2024, ju autorizohet procedim i mëtejshëm.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 72/2 prot

Pukë, më 28 .02.2025

VENDIM
NR. 06 datë 25.02. 2025

“ PER RISHQYRTIMIN E VENDIMIT NR. 55 DATE 03.12.2024 “ PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE TË EKONOMISË PYJORE “GOMSIQE “NJESIA ADMINISTRATIVE QERRET, PUKË TË BASHKISË PUKË”

Bazuar në Ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr 57/2020 për pyjet, kreu III, neni 11, gërma b, cihohet për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga Ministri, përjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës në Udhezimin nr.01 datë 26.01.2017 “Per mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor e kullosor, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të fondit pyjor e kullosor publik”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë , Këshilli Bashkiak pas shqyrtimit të projekt-vendimit;

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore “Gomsiqe”, Njesia Administrative Qerret, , Pukë, të Bashkisë Puke
2. Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore “Gomsiqe” është 7966.8 ha me një numër total ngastrash dhe nëngastrash **160**
3. Për vazhdimin e procedurave sipas ligjit nr 57/2020 për pyjet kreu III, neni 11, gërma b, ngarkohet Drejtoria Menaxhimit pyjeve, kullotave dhe bujqesisë, në Bashkinë Pukë
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Pyjeve , Kullotave dhe Bujqesisë , zyra kadastrës pyjore
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.
6. Vendimi u shpall me date 26.02.2025.
Vota të vlefshme gjithsej 9
Vota pro 9 , vota kunder 0 , vota abstenim 0

SEKRETARI
Hazbi Terbuni



KRYETARI
Gjon GJOKA